



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1612/6 prot.

Datë 13.09.2021

V E N D I M
Nr. 606/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 13.09.2021 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-03559-08-23-2021, me objekt: “*Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi*”, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, me fond limit 3.745.529 lekë parashikuar për tu zhvilluar në datën 03.09.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “INPRESS” SHPK
Adresa: Rruga: “Siri Kodra”, Ish-Blloku i magazinave tregtare, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.08.2021, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-03559-08-23-2021, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi”, për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, me fond limit 3.745.529 lekë parashikuar për tu zhvilluar në datën 03.09.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 30.08.2021, operatori ekonomik ankimues “INPRESS” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 1612/2 prot, datë 08.09.2021 “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK*” Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK.

II.5. Me shkresat nr. 1499/3 prot, datë 03.09.2021 dhe nr. 1525 prot, datë 03.09.2021, protokolluar përkatësisht me tonat me nr. 1612/3 prot, datë 08.09.2021 dhe nr. 1612/4 prot, datë 08.09.2021, autoriteti kontraktor ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “INPRESS” SHPK, si dhe i ka kthyer përgjigje ankimuesit me anë të shkresës nr. 1499/2 prot, datë 02.09.2021, duke e pranuar ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “INPRESS” SHPK, se: “*Së pari: Në pikën 2.2.1. “Kapacitetet teknike”, të Shtojcës 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të okumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:*

“1.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse

operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40 % te fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.”

Ky kriter i veçantë i kualifikimit: OE të paraqesë “një deklaratë për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020...”, është jo i qartë, ii) konfuzional, dhe iii) lë vend për interpretime dhe vlerësime subjektive të ndryshme nga AK, dhe rrjedhimisht nuk do të duhet të konsiderohet i përshtatshëm, dhe për këtë arsye do të duhet të ndryshohet/riformulohet.

a) Formulimi i këtij kriteri nuk përcakton qartazi përmbajtjen që do të duhet të parashtrojë "deklarata" e kërkuar në DST (kuptohet nëse ky nuk është ndonjë lapsus i AK).

Me fjalë të tjera, nuk kuptohet çfarë do të duhet të parashtrojnë OE pjesëmarrës nëpërmjet "deklaratës" së kërkuar: i) të listojnë xhiron vjetore të 3 viteve të fundit; ii) të deklarojnë se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit; iii) etj. .???

b) Në këtë kriter nuk përcaktohet "dokumenti konkret" për të vërtetuar xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, në zbatim të nenit 77 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Këtu do të donim të nënvizonim se OE pjesëmarrës mund të paraqesin lehtësisht dokumentacionin e vlefshëm ligjor “Vërtetim për Xhiron Vjetore të 3-viteve të fundit” i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga portali elektronik e-albania.

Përsa më sipër, kërkojmë ndryshimin/riformulimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.1. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të DST, pasi nuk është në përputhje me dispozitat e LPP dhe Rregullave të prokurimit publik, është jo i qartë, konfuzional dhe lë vend për interpretime dhe vlerësime subjektive të ndryshme nga AK.

Së dyti: Në pikën 2.2.2. “Kapacitet teknike”, të Shtojcës 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

1.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të bilanceve të viteve 2018, 2019 dhe 2020 nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Shënim 2.1:

Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Shënim 2.2:

Detyrimisht sipas përcaktimeve ligjore, kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Ky kriter i veçantë i kualifikimit: OE të paraqesë "një deklaratë" të bilanceve të viteve 2018 2019 dhe 2020...”, është jo i qartë. ii) konfuzional, dhe iii) lë vend për interpretime dhe vlerësime subjektive të ndryshme nga AK, dhe rrjedhimisht nuk do të duhet të konsiderohet i përshtatshëm, dhe për këtë arsye do të duhet të riformulohet/ndryshohet.

a) Formulimi i këtij kriteri “një deklaratë të bilanceve të viteve 2018, 2019 dhe 2020...” është

gjuhësisht i pakuptueshëm, si nga ana drejtëshkrimore, ashtu edhe nga ana sintaksore dhe logjike;

b) Formulimi i këtij kriteri nuk përcakton qartazi përmbajtjen që do të duhet të parashtrojë "deklarata" e kërkuar në DST kuptohet nëse ky nuk është ndonjë lapsus i AK;

c) Në këtë kriter nuk përcaktohet "dokumenti konkret" për të vërtetuar Bilancet e Certifikuara të 3-viteve të fundit 2018, 2019 dhe 2020, në zbatim të nenit 77 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik". Këtu do të donim të nëvizonim se OE pjesëmarrës mund të paraqesin lehtësisht dokumentacionin e vlefshëm ligjor "Bilancet e Certifikuara të 3-viteve të fundit, nga Drejtoria e Tatimeve" i cili është lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë OE pjesëmarrës.

Përsa më sipër, kërkojmë ndryshimin / riformulimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.2. "Kapacitet teknike", të Shtojcës 8 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të DST, pasi nuk është në përputhje me dispozitat e LPP dhe rregullave të prokurimit publik, është jo i qartë konfuzional dhe lë vend për interpretime dhe vlerësime subjektive të ndryshme nga AK.

Së treti: Në pikën 2.3.2. "Kapacitet teknike", të Shtojcës 8 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

2. Operatori ekonomik për të vërtetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme:

- Minimumi një makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm;
- Minimumi një makinë qepëse;
- Minimumi një makinë telefoni;

Operatori ekonomik për të vërtetuar se i disponon këto tre pajisje duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

- Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose
- Kontratë huapërdorje, ose
- Kontratë qiramarrje, ose
- Kontrata e dhurimit;

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën prane AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit tëfituesit.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktor, që operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet/makineritë "... disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomikë duhet "...Kontratë shitblerje/faturë shitblerje, ose/ kontratë huapërdorje, ose kontratë qiramarrje / ose kontrata e dhurimit..., ... është një kërkesë jo e plotë dhe shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit, si dhe ul ndjeshëm konkurrencën.

Pajisjet / makineritë e printimeve dhe shtypshkrimeve, në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe Kodit Civil në veçanti, janë pasuri të luajtshme të cilat nuk kanë nevojë dhe nuk parashikohet nga legjislacioni shqiptar aktualisht në fuqi, që të regjistrohen në ndonjë regjistër të veçantë publik, si në rastin e automjeteve. Për këtë arsye edhe vërtetimi / provimi i zotërimit / disponimit real të këtyre pajisjeve / makinerive mund të provohet me çdo lloj dokumentacioni të

nevojshëm ligjor, pasi si pronësia, ashtu edhe posedimi ligjor i këtyre pasurive të paluajshme mund të provohet me çdo formë ligjore të parashikuara nga dispozitat e Kodit Civil.

Për këtë arsye përshkrimi shterues që përcaktohet në pikën 2.3.2. "Kapacitet teknike", të Shtojcës 8 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të Dokumentave Standarte të Tenderit, ku për vërtetimin e zotërimit/posedimit/disponimit të këtyre pajisjeve/makinerive të shtypshkrimit të kërkuara në DST, kërkohet: "...paraqitja e "... Kontratë shitblerje / Faturë shitblerje, ose / Kontratë huapërdorje, ose Kontratë qiramarrje, ose Kontrata e dhurimit, ..., është një kriter diskriminues dhe jo në përputhje me Ligjin Nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", në veçanti, si dhe legjislacionit shqiptar në përgjithësi.

Përveç mënyrave të vërtetimit / provimit të përcaktuara në DST, fare mirë zotërimi / posedimi / disponimi i pajisjeve / makinerive të printimit dhe shtypshkrimit mund të provohet në mënyrë ilustruese dhe jo shteruese edhe me dokumentacion përkatës së blerjes së këtyre pajisjeve / makinerive në ankand: bilanceve të shoqërive tregtare të depozituara rregullisht pranë organeve të tatim-taksave ku këto paisje mund të jenë rregullisht të deklaruara), etj.

Si rrjedhojë, kriteri i veçantë kualifikues: "disponimin e këtyre makinerive operatorët ekonomikë duhet "...Kontratë shitblerje / Faturë shitblerje, ose / Kontratë huapërdorje, ose Kontratë qiramarrje / ose Kontrata e dhurimit ...", do të duhet të ndryshohet, duke përfshirë, ose në mënyrë shteruese të gjitha mënyrat dhe format ligjore të zotërimit / posedimit / disponimit të pajisjeve / makinerive të shtypshkrimit të kërkuara në DST, ose të përcaktojë në mënyrë ilustruese dhe Jo-Shteruese, disa nga këto mënyra forma ligjore, por duke vendosur në mënyrë të detyrueshme edhe fjalën "etjerë (etj.)" në fund të fjalisë, duke përfshirë kështu edhe mënyrat e tjera të vërtetimit të zotërimit / posedimit / disponimit të pajisjeve / makinerive të shtypshkrimit të kërkuara në DST, siç janë edhe dokumentacioni përkatës së blerjes së këtyre pajisjeve / makinerive në ankand; bilanceve të shoqërive tregtare të depozituara rregullisht pranë organeve të tatim-taksave (ku këto pajisje mund të jenë të deklaruara), etj.

Së katërti: Në pikën 2.3.3. "Kapacitet teknike", të Shtojcës 8 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

| Stafi | Nr. |
|----------------------|-----|
| Shofer | 1 |
| Punetore te thjeshte | 1 |
| Total | 2 |

- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe leje drejtimi.
- Për punonjësin e punësuar punëtorë të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune përkatëse.

- *Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:*

| <i>Nr</i> | <i>Emer Mbiemer</i> | <i>Profesioni</i> | <i>Kodi i deklaramit ne Liste Pagese</i> | <i>Data e fillimit te marredhenieve te punes</i> |
|-----------|---------------------|-------------------|--|--|
|-----------|---------------------|-------------------|--|--|

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe lejen e drejtimit të punonjësit pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

*Edhe ky kriter kualifikues është i) diskriminues, ii) jo - në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që po prokurohet, dhe iii) nuk kanë lidhje me objektin e kontratës; si dhe iv) nuk do të duhet të konsiderohet i përshtatshëm, **dhe rrjedhimisht do të duhet të hiqet.***

Së pari, në këtë kriter të veçantë kualifikues, Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara kërkon në mënyrë të kundraligjshme që: "OE pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, do të duhet të kenë në dispozicion numrin e nevojshëm të punonjësve":

| <i>Stafi</i> | <i>Nr.</i> |
|-----------------------------|------------|
| <i>Shofer</i> | 1 |
| <i>Punetore te thjeshte</i> | 1 |
| | |

Përsa më sipër, kriteri kualifikues që OE pjesëmarrës do të duhet të kenë në dispozicion punonjës } shofer; ii} punëtor i thjeshtë; do të duhet të hiqet, pasi bie në kundërshtim të plotë me LPP.

Së dyti. Është absurde nga ana e AK, të pretendosh që OE pjesëmarrës të kenë domosdoshmërisht në stafin e tyre dhe në listëpagesat e OE, një punonjës me titullimin "shofer". AK mund të kërkojë fare mirë që ndonjë prej punonjësve që është pjesë e stafit të OE pjesëmarrës të ketë Lejen e Drejtimit të vlefshme për të drejtuar automjetin që do të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt të kontratës prokuruese pranë ambienteve të AK, por kurrësesi nuk mund të pretendojë nga OE pjesëmarrës që të kenë një punonjës të dedikuar me titullimin "shofer" në listëpagesë.

Profesioni "shofer" nuk është aspak i lidhur drejtëpërdrejtë dhe teknikisht / profesionalisht me realizimin me sukses të kontratës, objekt ankese. Mallrat / shërbimet e kërkuara nga AK nëpërmjet kësaj procedure prokuruese lidhen drejtëpërdrejtë me prodhimin e shtypshkrimeve.

Gjithashtu, për një OE pjesëmarrës në këtë procedurë prokuruese, drejtuesin e automjetit, që do të realizojë transportin / shpërndarjen e mallrave të kërkuara pranë ambjenteve të AK, mund ta kryejë fare mirë, me anë të një punonjësi tjetër (me një titullim tjetër) në listëpagesën e OE

pjesëmarrës, të cilët kanë lejet e nevojshme të drejtimit të automjetit që disponon OE pjesëmarrës. Përshembull, transportin e mallrave pranë ambienteve të AK, mund ta realizojë fare mirë edhe një punonjës: offsetist / makinist; ndihmës offsetist / makinist; libërlidhës magazinier; etj. të cilët zotërojnë lejet e nevojshme të drejtimit për automjetin që disponon OE pjesëmarrës.

Rrjedhimisht, ky kriter është tërësisht i panevojshëm, jo i lidhur me objektin e kontratës, jo porporcional, dhe për këtë arsye do të duhet të hiqet.

Së treti, gjithashtu, kërkesa e AK, që OE pjesëmarrës do të duhet të kenë 1 "punonjës të thjeshtë", përveç se absurde dhe e pakuptimtë, bie edhe në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 77, pika 1 e ligjit 162/2020 "Për prokurimin Publik", ku përcaktohet qartësisht se: "Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar se një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të ketë."

Disponimi i "1 punëtor i thjeshtë", nuk është apsak esenciale teknikisht dhe profesionalisht, dhe domosdoshmëri për realizimin me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht edhe ky kriter do të duhet të hiqet., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT " Pikat 1.2.1 dhe 1.2.2 të "Kaoaciteti ekonomik dhe financiar", si dhe pikat 2.3.2 dhe 2.3.3 "Kapaciteti teknik" të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor kishte përcaktuar kriteret kualifikuese si më poshtë:

"1.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40 % te fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare."

"1.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të bilanceve të viteve 2018, 2019, dhe 2020 nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore prane AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Shënim 2.1:

Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Shënim 2.2:

Detyrimisht sipas përcaktimeve ligjore, kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.”.

“2.3.2. Operatori ekonomik për të vërtetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme:

- Minimumi një makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm;
- Minimumi një makinë qepëse;
- Minimumi një makinë celefoni;

Operatori ekonomik për të vërtetuar se i disponon këto tre pajisje duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

- Kontrate shitblerje/ Fature shitblerje, ose
- Kontratë huapërdorje, ose
- Kontratë qiramarrje, ose
- Kontrata e dhurimit;

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten prane AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.”.

“2.3.3. "Kapacitet teknike", të Shtojcës 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të Dokumentave Standarte të Tenderit të sipërcituar, përcaktohet:

Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshte:

| Stafi | Nr. |
|----------------------|-----|
| Shofer | 1 |
| Punetore te thjeshte | 1 |
| Total | 2 |

- Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe leje drejtimi.
- Për punonjësin e punësuar punetore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune përkatëse.
- Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

| Nr | Emer Mbiemer | Profesioni | Kodi i deklaramit ne Liste Pagese | Data e fillimit te marredhenieve te punes |
|----|--------------|------------|-----------------------------------|---|
| | | | | |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | | | |
|--|--|--|--|--|

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës si dhe lejen e drejtimit të punonjësit pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.”.

III.1.2. Në datë 02.09.2021, autoriteti kontraktor me shkresën “Vendim” nr. 1499/2 prot, pranoi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “INPRESS” SHPK si më poshtë:

“Në dokumentat e tenderit, në pikën 1.2.1, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit, përcaktohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40 % të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

Në pikën 1, 2, dhe 3, të nenit 43, të VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. 43.2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave sqaron se bazuar në kriterin e mësipërm operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin vetëdeklarim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit. Në këtë deklaratë operatorët ekonomik duhet të deklarojnë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40 % të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.”.

Një kërkesë e tillë lidhur me paraqitjen e deklaratës është parë e arsyeshme nga njësia e prokurimit në fazën e parakualifikimit, me qëllim lehtësimin e operatorëve ekonomik lidhur me vonesat për procedurat e nxjerrjes së dokumenteve, si dhe uljen e kostove të tyre.

Vërtetimi për xhiron vjetore të tre viteve të fundit do të paraqitet nga operatorët ekonomik pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Gjithashtu, theksojmë se, është në vullnetin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës nëse ata zgjedhin të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore për periudhën 2015, 2019 dhe 2020 që në fazën e parakualifikimit. Kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur operatorët ekonomik zgjedhin të paraqesin vërtetim për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 1.2.1, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit.

Njësia e prokurimit duhet të shtojë në këtë kriter edhe opsionin e dorëzimit të vërtetimit për të gjithë operatorët ekonomikë që shprehin vullnetin të dorëzojnë këto të fundit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK qëndron.

Në dokumentat e tenderit, në kriterin e përcaktuar në pikën 1.2.2, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8, ku përcaktohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të bilanceve të viteve 2018, 2019 dhe 2020 nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Njësia e prokurimit ka sqaruar se operatorët ekonomikë, për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 1.2.2, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit duhet të paraqesin Vet-Deklarim, për raportin ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit të bilanceve të viteve të kërkuara, ku të deklaroj se ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, nuk ka humbje.

Një kërkesë e tillë lidhur me paraqitjen e deklaratës është parë e arsyeshme nga njësia e prokurimit në fazën e parakualifikimit, me qëllim lehtësimin e operatorëve ekonomik lidhur me vonesat për procedurat e nxjerrjes së dokumenteve si dhe uljen e kostove të tyre.

Kopjet të certifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, si dhe raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, në rastet kur operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 do të paraqiten nga pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Gjithashtu, theksojmë se, është në vullnetin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës nëse ata zgjedhin të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore të shoqëruara me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore që në fazën e parakualifikimit.

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur edhe në rastet kur operatorët ekonomik zgjedhin të paraqesin dokumentet e sipërcituara për përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 1.2.2, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca

8, në dokumentet e tenderit, duke mbajtur parasysh kushtin e shënimit 2.2 të kësaj pike “nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”.

Njësia e prokurimit duhet të shtojë në këtë kriter edhe opsionin e dorëzimit të kopjeve të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2018, 2019, 2020) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, si dhe raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, në rastet kur operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, për të gjithë operatorët ekonomik që shprehin vullnetin të dorëzojnë këto të fundit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK qëndron.

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka ankimuar kriterin e përcaktuar në seksionin 2.3 “Kapaciteti teknik”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8 në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi procesverbalin e hartimit dhe miratimit të dokumentave të tenderit, dokumentat e tenderit të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik ankesën e paraqitur nga ankimuesi për këtë procedurë, ju komunikoi si më poshtë:

Në dokumentat e tenderit, në kriterin e përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8 në dokumentet e tenderit, ku përcaktohet se operatori ekonomik për të vërtetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme:

- Minimumi një makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm;
- Minimumi një makinë qepëse;
- Minimumi një makinë telefoni;

Operatori ekonomik për të vërtetuar se i disponon këto tre pajisje duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

- Kontratë shitblerje/ Faturë shitblerje, ose
- Kontratë huapërdorje, ose
- Kontratë qiramarrje, ose
- Kontrata e dhurimit;

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën prane AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Komisioni i shqyrtimit të ankesave sqaron në kriterin e mësipërm janë kërkuar për vërtetimin e pronësisë ose marrjes me qera të makinerive të kërkuara format kryesore që parashikon legjislacioni në fuqi.

Gjithsesi, KSHA arsyeton se për të shmangur çdo përjashtim që mund të vijë nga përcaktimi i formave të kërkuara, KSHA arsyeton se në kriterin e sipërcituar duhet shtuar:

Operatori ekonomik për të vërtetuar se i disponon këto tre pajisje duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga format e mëposhtme:

Kontratë shitblerje / faturë shitblerje, ose kontratë huapërdorje, ose

**Kontratë qiramarrje, ose kontrata e dhurimit;
ose çdo dokument tjetër sipas legjislacionit në fuqi.**

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK qëndron.

Operatori ekonomik “Inpress” SHPK ka ankimuar kriterin e përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8, në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi shqyrtoi procesverbalin e hartimit dhe miratimit të dokumentave të tenderit, dokumentat e tenderit të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik ankesën e paraqitur nga ankimuesi për këtë procedurë, ju komunikon si më poshtë:

Në dokumentat e tenderit, në kriterin e përcaktuar në pikën 2, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8 në dokumentat e tenderit ku përcaktohet se operatori/ët ekonomikë pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar, si më poshtë:

| <i>Stafi</i> | <i>Nr.</i> |
|-----------------------------|------------|
| <i>Shofer</i> | <i>1</i> |
| <i>Punetore te thjeshte</i> | <i>1</i> |
| <i>Total</i> | <i>2</i> |

- *Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune përkatëse si dhe leje drejtimi.*
- *Për punonjësin e punësuar punëtore të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune përkatëse.*
- *Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:*

| <i>Nr</i> | <i>Emer Mbiemer</i> | <i>Profesioni</i> | <i>Kodi i deklaramit ne Liste Pagese</i> | <i>Data e fillimit te marredhenieve te punes</i> |
|-----------|---------------------|-------------------|--|--|
|-----------|---------------------|-------------------|--|--|

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës, si dhe lejen e drejtimit të punonjësit pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka komunikuar në rrugë elektronike me njësinë e prokurimit për duke kërkuar për punonjësit e kërkuar për shërbimin e transportit, të na specifikoni profesionet që këta punonjës duhet të kenë në listëpagesë dhe në kontratë pune që kriteri i mësipërm të konsiderohet i përmbushur nga operatorët ekonomik.

Njësia e prokurimit ka sqaruar se në lidhje me kriterin e përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik”, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, Shtojca 8 në dokumentet e tenderit, ku është kërkuar se: për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, shërbimin e transportit operatori ekonomik, duhet të ketë minimalisht të punësuar një shofer dhe një punëtor të thjeshtë. Ky kriter është vendosur duke mbajtur parasysh objektin e prokurimit, si dhe shpërndarjen në ambjentet e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë. Për punonjësit e kërkuar në tabelën në pikën 2.3.3 operatori ekonomik mjafton të deklarojë stafin e kërkuar për realizimin e transportit, pavarësisht profesionit të tyre, në kontratën e punës, mjafton njeri prej punonjësve të disponojë leje drejtimi. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK ku pretendon se: “... AK mund të kërkojë fare mirë që ndonjë prej punonjësve që është pjesë e stafit të OE pjesëmarrës të ketë leje drejtimi të vlefshme për të drejtuar automjetin që do të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt të kontratës prokuruese pranë ambienteve të AK, por kurrësesi nuk mund të pretendojë nga OE pjesëmarrës që të kenë punonjës të dedikuar me titullimin “shofer” në listëpagesë ...”, si dhe bazuar në sqarimin e dhënë për këtë pikë nga njësia e prokurimit, sqarojmë se kriteri do të konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e dokumentave dhe të dhënave të kërkuara në këtë pikë, për dy punonjësit të cilët do u marrin përsipër shërbimin e transportit, konkretisht në funksionin e shoferit dhe punonjësit të thjeshtë, pavarësisht funksionit në kontratën e punës dhe kodeve përkatëse në listëpagesë.

Njësia e prokurimit duhet të riformulojë kriterin duke sqaruar:

Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, shërbimin e transportit duhet të ketë minimalisht të punësuar pavarësisht funksionit të tyre në subjekt, si më poshtë:

| Stafi | Nr. |
|----------------------|-----|
| Shofer | 1 |
| Punetore te thjeshte | i |
| Total | 2 |

Për punonjësin e punësuar shofer të paraqitet kontratë pune përkatëse, si dhe leje drejtimi. Për punonjësin e punësuar punëtorë të thjeshtë të paraqitet vetëm kontratë pune përkatëse.

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

| Nr | Emer Mbiemer | Profesioni | Kodi i deklarimit ne Liste Pagese | Data e fillimit te marredhenieve te punes |
|----|--------------|------------|--------------------------------------|--|
| | | | | |

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës, si dhe lejen e drejtimit të punonjësit pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK qëndron.

III.1.3. Neni 21, pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.”.

Neni 24, pika 1 “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

Neni 30, pika 1 “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.”.

Neni 110 pika 1 “Afatet për ankim” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”.

Neni 115, pika 1/b dhe pika 3/b “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

Neni 118, pika 2/ç “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”.

III.1.3. Referuar metodës së interpretimit sistematik (*domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 24/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 21 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 110 pika 1 të LPP-së, parashikohet se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të

kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimues duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cenuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimues se procedurave për fitimin e kontratave publike, do ti nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe përmbushjes së specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi), të cilat duhet të përmbushin parakushtin *sine qua non* të parashikuar nga neni 77 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në rastin konkret, KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka shqyrtuar dhe pranuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, duke mos pasur më objekt të ankesës së ankimuesit.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 118, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë shqyrtimin administrativ për ankesën e operatorit ekonomik “INPRESS” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-03559-08-23-2021, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi”, për Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, me fond limit 3.745.529 lekë parashikuar për tu zhvilluar në datën 03.09.2021, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INPRESS” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri